



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:276973
Datë: 08.07.2024
Numri i dokumentit: 05911359

AA.nr.306/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Valon Totaj dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses N.S nga Prizreni, kundër të paditurës, Oda e Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, përfaqësuar me autorizim nga Besim Abdullahu, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1465/19, të datës 21.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 01.07.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditëses N.S nga Prizreni, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1465/19, i datës 21.02.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1465/19, të datës 21.02.2023, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses N.S nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet aktvendimi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZPD) të Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë nr.10-5/2019 të datës 12.04.2018 dhe Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, Nr. 596/2019 të datës 27.04.2019.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësjë, për shkak të: shkeljes së dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike

dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në kuptim të ofrimit të mbrojtjes gjyqësore për paditësen.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Zyra e Prokurorit Disiplinor e Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, me vendimin Nr. 10-5/2018, të datës 12.04.2018 e ka hedhe poshtë fletëparaqitjen disiplinore me numër 10/2018 të datës 02.02.2018 e ushtruar nga N.S nga Prizreni kundër avokates B.B, me zyrë në Prizren, për shkak së veprimet e të paraqiturës në raport me ushtruesen e fletëparaqitjes janë të parashkruar në bazë të Ligjit për Avokatinë neni 56.

Paditësja e pa kënaqur me vendimin e lartcekur të Zyrës së Prokurorit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 21.06.2019, duke kontestuar ligjshmërinë e tij, me propozim që i njëjti të anulohet.

Gjykata e shkallës së parë pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, e duke u bazuar në provat dhe dokumentacionin që gjendet në shkresat e lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar, duke lënë në fuqi vendimin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës në Prishtinë. Me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e pabazuar. Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi, gjykata fillimisht iu referua Ligjit nr. 03/L-117 për Avokatinë, konkretisht nenit 56 par. 1 dhe 2 i cili përcakton se: “1. Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të lehta parashkruhet gjashtë (6) muaj pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe kryesin, kurse në çdo rast parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej një (1) viti prej ditës së kryerjes së shkeljes. 2. Fillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda, parashkruhet një (1) vit pas njoftimit për shkeljen e bërë dhe për kryesin, kurse gjithsesi parashkruhet pas kalimit të afatit kohor prej dy (2) vjetësh prej ditës së kryerjes së shkeljes”. Duke u bazuar në dispozitat e sipërcituara, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e vendosjes dhe në bazë të provave në shkresat e lëndës, gjykata vlerësoi se paditësja ka paraqitur fletëparaqitje disiplinore ndaj avokates B.B, me datën 02.02.2018, ndërsa shkelja e pretenduar nga ana e avokates është bërë me datën 12.11.2013, kur e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.270/2013 dhe për këtë nuk e ka njoftuar*

paditësen. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se, e paditura drejtë ka vendosur, kur ka refuzuar ankesën e paditëses dhe atë duke u bazuar në dispozitat e lartcekura. Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditëses të dhëna në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, por me asnjë provë nuk dëshmoi pretendimet e tij, se avokatja në fjalë ka bërë shkelje të Kodit të Etikës Profesionale, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje juridike. Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material, kur është refuzuar ankesa e paditësit”.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të pretendimeve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimor se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave procedurale, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor për vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i apelit vëren se paditësja në ankesë kësaj shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk e ka arsyetuar fare se ku qëndron vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike nga Gjykata e shkallës së parë, edhe pse gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, pasi që, Gjykata e shkallës së parë iu referua Ligjit nr. 03/L-117 për Avokatinë, konkretisht nenit 56 par. 1 dhe 2, të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e vendosjes dhe në bazë të provave në shkresat e lëndës, gjykata vlerësoi se paditësja ka paraqitur fletëparaqitje disiplinore ndaj avokates B.B, me datën 02.02.2018, ndërsa shkelja e pretenduar nga ana e avokates është bërë me datën 12.11.2013, kur e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.270/2013 dhe për këtë nuk e ka njoftuar paditësen.

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që paditësja me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e saj ankimore, ndërsa provat e propozuara si prova të bashkangjitura me shkresat e lëndës nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale.

Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditëses, por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njëjtat nuk i ka provuar me asnjë provë, në gjykatën e shkallës së parë e as me ankesën e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate vendimi i kontestuar i të paditurës dhe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, dhe si i tillë aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses dhe lënies në fuqi të vendimit të lartcekur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.306/2023, me datë 01.07.2024

Kryetari i kolegjit,

Ramiz Kuqi